

PYETJET MË TË SHPESHTA RRETH SFIDËS SË PARË CIKLI 6-9

Çfarë ngjyre kanë LED diodat?

LED diodat janë diodat e vendosura në pjesën e përparme të robotit, të cilat shkëlqejnë gjithmonë vetëm në ngjyrë të kuqe.



Cilat PIN (porte) duhet të caktohen në bllokun për aktivizimin e sensorit 'ultrasonic'?

Në bllokun për aktivizimin e sensorit 'ultrasonic', duhet të caktohen portet P13 dhe P14.



A mund të përdoren edhe melodi të tjera apo vetëm ajo e caktuar në udhëzime?

Nuk duhet të përdoren melodi të tjera, përpos melodisë që është e caktuar në udhëzime.



Si paraqitet në kod ngjyra e bardhë dhe ngjyra e zezë të cilën e lexon roboti?

Në kod, ngjyra e bardhë dhe ngjyra e zezë paraqiten me vlera numerike. Kur sensori 'line tracking sensor' është mbi ngjyrën e bardhë e ka vlerën 0, ndërkah mbi ngjyrën e zezë, e ka vlerën 1.

